



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:124778
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06080210

E.nr.162/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Blerim Istrefi dhe me bashkëpunëtoren profesionale Fitore Ahmeti Xhafa, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit: M...-APK-D...K.... në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson A. D. drejtor me seli në Mitrovicë me adresë: rr."A. ..." Objekti i ish shtëpisë së mallrave "... " kati i III, kundër të debitorit B.H me vendbanim në T...n e Parë, Komuna e Mitrovicës, lidhur me pagesën e borxhit në bazë të Aktgjykimit P.nr.81/11 të datës 19.09.2011 përmbartimi është i lejuar me aktvendimin E.nr.162/12 të datës 17.03.2016, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.08.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.KOSIDEROHET i tërhequr propozimi për përmbartim me numër E.nr.162/12 i datës 24.04.2012 i kreditorit M...-APK-D...K.... në Mitrovicë, kundër debitorit B.H nga M..., lidhur me pagesën e borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor, i lejuar me aktvendimin E.nr. 162/2012 të dt. 17.03.2016.

A r s y e t i m

Kreditori M...-APK-D...K.... në Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përmbartim me datën 24.04.2012 kundër debitorit B.H me vendbanim në T...n e Pare, Komuna e Mitrovicës, për përmbushjen e borxhit.

Gjykata me datën 10.06.2024 ka nxjerrë konkluzion me të cilin e ka detyruar kreditorin M...-APK-D...K.... në Mitrovicë, që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, gjykatës ti sigurojë të dhënat e nevojshme se a është përmbushur borxhi nga ana e debitorit me qëllim të procedimit të më tutjeshëm në këtë çështje përmbartimore, duke e paralajmëruar edhe për pasojat se nëse nuk veprohet sipas udhëzimeve në konkluzion, gjykata propozimin për përmbartim do ta konsideroj se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.

Andaj, Gjykata duke e marrë parasysh se kreditori nuk veproi sipas konkluzionit E.162/2012 të datës 10.06.2024 të kësaj gjykate, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u mbështetur në nenin 17 të LPP-së e në lidhje me nenin 99 dhe 102 paragrafi 3 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2023:124778
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06080210

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË
E.nr.162/2012 me datë 23.08.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.